

**VENDIM****Nr. 745, datë 26.10.2016****PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE TË PËRBASHKËTA KUFITARE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 6, të Ligjit Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Verifikimet kufitare në pikat e kalimit kufitar kryhen sipas parimit “një ndalesë-një verifikim”, duke mundësuar lehtësimin e kalimit të kufirit për personat, mjetet e të mirat materiale, si dhe duke siguruar një verifikim sa më të efektshëm me pjesëmarrjen e të gjitha autoriteteve përgjegjëse që veprojnë në pikën përkatëse të kalimit kufitar.
2. Parashikimi i pikës 1 zbatohet për autoritetet përgjegjëse shqiptare që veprojnë në kufi edhe në rastin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar.
3. Mosprezenca e një autoriteti të caktuar gjatë verifikimit kufitar të vijës së parë nuk kushtëzon apo nuk pengon autoritetet e tjera për të kryer verifikim kufitar.
4. Çdo element verifikimi i vijës së parë, për llogari të çdo autoriteti, i cili ka nevojë për verifikim, inspektim apo ekzaminim të mëtejshëm që nuk mund të kryhet për një kohë të shkurtër në zonën e vijës së parë, konsiderohet arsye për verifikim të vijës së dytë.
5. Gjatë verifikimeve të vijës së dytë, çdo autoritetet i pranishëm në kufi që ka kompetenca dhe detyrime në lidhje me natyrën e verifikimit në fjalë, ka të drejtë të marrë pjesë në verifikim, përveç rasteve kur nga kjo prani rrezikohen hetimet për një vepër penale, identiteti i viktimave të mundshme të trafikimit, identiteti i dëshmitarëve të mbrojtur, ose informacioni i klasifikuar.
6. Autoritetet përgjegjëse që operojnë në pikën e kalimit kufitar përdorin ose shfrytëzojnë bashkarisht pajisjet, mjetet dhe mjediset e verifikimit kufitar, veçanërisht të vijës së dytë, pavarësisht pronësisë së këtyre pajisjeve apo mjedisëve.

<sup>1</sup>Hyrë në fuqi më 03.11.2016; Faqe 22075 - 22078

*Ky vendim është përafëruar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, “Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)”, numri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016, faqe 1 – 52.*

7. Parashikimi i pikës 6 zbatohet edhe në rastin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar.
8. Në verifikimet e vijës së dytë, ku nevojitet ekspertizë profesionale në tërësi ose për elemente të veçanta verifikimi, veprimet e drejtpërdrejta në lidhje me këto elemente kryhen nga punonjësit e atij autoriteti që ka ekspertizën përkatëse, ose nga një ekspert i jashtëm në rastet kur asnjë autoritet nuk ka punonjës me ekspertizë në këto fusha.
9. Për verifikimet kufitare të vijës së dytë, në të cilat, për arsye kompetence, profesionalizmi apo ekspertize, nevojitet pjesëmarrja e një autoriteti që nuk vepron në kufi, ose vepron me orar të kufizuar, njoftohet autoriteti përkatës me anë të telefonit, postës elektronike apo në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të njoftimit.
10. Mosparaqitja brenda një kohe të arsyeshme e autoritetit të njoftuar sipas parashikimit të pikës 9, nuk kushtëzon moskryerjen e verifikimit kufitar, përveç rasteve kur prania e autoritetit kompetent është absolutisht e domosdoshme.
11. Verifikimet e kryera nga Policia Kufitare dhe Migracionit në brendësi të territorit, në kuptimin e nenit 7, të Ligjit nr 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, kryhen gjithashtu në bashkëpunim me autoritete të tjera, kur ekspertiza e tyre është e nevojshme.
12. Për verifikimet e parashikuara në pikën 11, për automjetet apo ngarkesat e plumbosura nga shërbimi doganor, automjetet apo ngarkesat me ushqime, kafshë, bimë, ose sende të tjera të natyrës së veçantë, njoftohen shërbimet më të afërta të autoritetit përgjegjës përkatës me anë të telefonit, postës elektronike, apo në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të njoftimit, me qëllim që ndërhyrja për verifikim të kryhet sipas legjislacionit të fushës, përveç rasteve kur nga vonesa mund të rezikohen jetët e njerëzve, hetimet për një vepër penale, identiteti i viktimave të mundshme të trafikimit, identiteti i dëshmitarëve të mbrojtur, ose informacioni i klasifikuar.
13. Në rastin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, pavarësisht territorit ku ato ndodhen, autoritetet përgjegjëse shqiptare mund të kryejnë verifikime të përbashkëta kufitare me autoritetet përgjegjëse fqinje, në përputhje me marrëveshjen përkatëse dhe duke respektuar parimet e mëposhtme:
  - a. Aksesin në mbrojtjen ndërkombëtare sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, për personat që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, në çdo kohë, kur pika e përbashkët e kalimit kufitar gjendet në territorin shqiptar dhe në momentin që ka përfunduar procedurat e daljes nga vendi fqinj, kur pika e përbashkët gjendet në territorin e vendit fqinj;
  - b. Shkëmbimin e informacionit të nevojshëm dhe informimin e saktë të palëve në lidhje me faktet dhe provat, në rastin e çështjeve që justifikojnë ndalimin apo arrestimin e një personi ose bllokimin e një sendi, si dhe transferimin e personit ose sendit tek pala që ndjek çështjen, pavarësisht nga shtetësia e personit ose vendi i regjistrimit të sendit;
  - c. Mospengimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të personit që gëzon këtë të drejtë, pavarësisht ekzistencës së motiveve për refuzim daljeje nga pala tjetër,

- kur në legjislacionin e kësaj pale ekziston një parashikim për këtë, dhe shkëmbimin e informacionit mbi këto motive, për të mundësuar një trajtim të përshtatshëm të rastit;
- ç. Vendosjen dhe përdorimin e përshtatshëm të sistemeve elektronike dhe bazave të të dhënave, duke ruajtur të dhënat personale nga dëmtimi ose humbja aksidentale apo e paligjshme, nga modifikimi, dekonspirimi, ose aksesit i paautorizuar i tyre, përfshi këtu aksesin nga shtetet që nuk e gëzojnë këtë të drejtë.
14. Për kryerjen në mënyrë të efektshme të verifikimeve të përbashkëta kufitare, Pikat e Kalimit Kufitar pajisen përkatësisht me mjediset, mjetet dhe paisjet si më poshtë vijon:
- Pikat e kalimit kufitar për qarkullim ndërkombëtar të personave pa automjete pajisen, minimalisht, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
  - Pikat e kalimit kufitar për qarkullim ndërkombëtar të personave dhe automjeteve jo të rënda, pajisen, minimalisht, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 2 që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij;
  - Pikat e kalimit kufitar për qarkullim ndërkombëtar të mjeteve dhe mallrave, pajisen, minimalisht, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
15. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministrinë dhe autoritetet e tjera që kanë kompetenca dhe detyrime në lidhje me kufirin shtetëror, sipas përcaktimeve të bëra në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Planin e saj të Veprimit, marrin masa për paisjen e Pikave të Kalimit Kufitar me mjediset, mjetet dhe paisjet, në përputhje me shtojcat përkatëse të këtij vendimi, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse të tyre apo të secilit institucion të varësisë që vepron në pikën e kalimit kufitar, duke i konsideruar ato si kritere standarde minimale.
16. Për çështje të veçanta të verifikimit të përbashkët kufitar, të cilat kanë nevojë për specifikime konkrete të veprimtarisë së dy a më shumë autoriteteve, Ministrat e linjës nxjerrin urdhër të përbashkët në zbatim të këtij vendimi.
17. Për çështje të veçanta të verifikimit kufitar, të cilat kanë nevojë për specifikime konkrete të veprimtarisë së strukturave vartëse të Ministrive të linjës, Ministri përkatës nxjerr urdhër në zbatim të këtij Vendimi.
18. Veprimet dhe bashkëpunimi i strukturave të Policisë së Shtetit për verifikimin e përbashkët kufitar përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.
19. Veprimet konkrete të Policisë Kufitare dhe Migracionit gjatë verifikimit kufitar rregullohen në procedurat standarde të punës të Policisë Kufitare dhe Migracionit.
20. Për përfshirjen dhe zbatimin e praktikave më të mira të verifikimit kufitar, Policia Kufitare dhe e Migracionit përgatit udhëzuesin e vet, i cili shërben si referencë për kryerjen e verifikimeve të efektshme në një kohë sa më të shkurtër.

21. Pikat 1, 2, 4, 5, 6, 7 dhe 8, të vendimit Nr. 1018, datë 30.09.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e standardeve dhe të kriterëve të kontrollit në pikat e kalimit të kufirit, në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohen.
22. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Z È V E N D È S K R Y E M I N I S T R I**

**NIKO PELESHI**

## **Shtojca 1: Ambientet, mjetet dhe pajisjet minimalisht të nevojshme në PKK për qarkullim ndërkombëtar të personave, pa automjete:**

### 1. Ambiente

- objekt me infrastrukturë të përshtatshme komunikacioni, telekomunikacioni, akomodimi dhe ndriçimi, i mbështetur me gjenerator të përshtatshëm energjie;
- ambientezyre për shërbimet e autoriteteve përgjegjëse që operojnë në pikën e kalimit.
- ambiente të përshtatshme për qarkullimin dhe verifikimin e personave në vijën e pare;
- dhomë intervistimi dhe kontrolli personal;
- dhomë për ndalim personash (të ndara sipas gjinisë);
- dhoma për të kthyerit / riatdhesuarit dhe azilkërkuesit (të ndara sipas gjinisë);
- depo për armatimin;
- vendparkim për automjete zyrtare;

### 2. Pajisje teknike-police dhe pajisje të tjera speciale si në vijim:

- lente portable për verifikim dokumentash;
- burim drite ultra violet portable për verifikim dokumentash;
- burim drite të bardhë portable për verifikim dokumentash;
- pajisje stacionare për verifikimin e pasaportave me lente, me burim drite të bardhë dhe me burim drite UV;
- dritë dore;
- krahasues videospektral për dokumenta;
- pajisje portable për verifikimin/matjen e radioaktivitetit;
- mikroskop për verifikim dokumentash në vijën e dytë;
- laborator portabël për ekzaminimin e dokumentave në vijën e dytë;
- skaner i gjurmëve të gishtave;
- aparat fotografik dixhital;
- videokamera dixhitale;
- matës alkooli;
- komplete testi portabël për zbulimin e drogave dhe eksplozivëve;
- sistem video survejimi për sistemin e sigurisë në PKK (CCTV);

### 3. Pajisje zyre:

- diktofonë;
- fax (laser fax);
- printer

- skaner
- fotokopje
- videoregjistrues
- televizorë;
- videoprojektor.

4. Hardëare dhe softëare për kompjuterizimin e sistemit të verifikimitkufitar:

- stacione pune (kompjuter i lidhur në rrjet) të standardit profesional me burim të pa ndërprerë energjie;
- lexues stacionar / portabël dokumentash;
- pajisje portable për mbledhjen, krahasimin dhe verifikimin e të dhënave;
- servera komunikimi me burim të pa ndërprerë energjie;
- servera të bazave të të dhënave meburim të pa ndërprerë energjie;
- servera qendror për procesimin e bazave të të dhënave me burim të pa ndërprerë energjie;
- baza të dhënash për verifikimin optimal të personave në vijën e pare dhe të dytë;

## **Shtojca 2: Ambientet, mjetet dhe pajisjet minimalisht të nevojshme në PKK për qarkullim të personave me autovetura dhe automjete të tjera jo të rënda.**

### 1. Ambiente

- ambiente të përshtatshme për qarkullimin dhe verifikimin e personave dhe automjeteve jo të rënda në vijën parë;
- ambient i veçantë për inspektimin fizik të automjeteve në vijën e dytë;
- ambient për sendet dhe mallrat e bllokuara / sekuestruara që transportohen në automjete jo të rënda;
- hapësirë / ambient për parkimin dhe ruajtjen e automjeteve të bllokuara;
- dhomë mbledhjesh / prezantimesh;

### 2. Pajisje tekniko-policore dhe pajisje të tjera speciale si në vijim:

- pasqyrë për inspektimin e mjeteve të transportit nga poshtë gjatë verifikimit të vijës së parë;
- minilaborator për verifikimin e dokumentave të personave dhe automjeteve në vijën e dytë
- pajisje për zbulimin e sipërfaqeve johomogjene / me ndryshim të struktues origjinale;
- pajisje për matjen e dendësisë së gomave të automjeteve;
- pajisje video-optike për inspektimin e sarbatorëve të karburantit;
- pajisje video - optike për inspektimin e hapësirave boshe të automjeteve dhe sendeve;
- komplete pajisjesh profesionale për zbrëthim mbërthim të automjeteve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre;
- pajisje portable për zbulimin e radioaktivitetit gjatë verifikimit të vijës së dytë;
- pajisje për ndriçim të mjaftueshëm gjatë inspektimit të automjeteve;

### 3. Hardware dhe software për kompjuterizimin e sistemit të verifikimit kufitar:

- baza të dhënash për verifikimin optimal të personave dhe automjeteve në vijën e parë dhe të dytë;
- stacione pune (kompjuter i lidhur në rrjet) të standardit profesional me burim të pa ndërprerë energjie në ambientet e verifikimit të automjeteve në vijën e dytë;
- sistem i leximit automatik për targat e automjeteve;

### **Shtojca 3: Ambientet, mjetet dhe pajisjet minimilasht të nevojshmenë PKK për qarkullim të personave, automjeteve dhe mallrave:**

#### 1. Ambiente:

- ambiente të përshtatshme për qarkullimin dhe verifikimin e personave dhe automjeteve jo të rënda në vijën parë;
- ambient magazinimi për mallrat tregtare të bllokuar;
- ambiente për inspektimin e mallrave të natyrës së veçantë (ushqimore, veterinare, bimore);
- ambiente magazinimi për mallrat e natyrës së veçantë të bllokuara / sekuestruara;
- ambiente të veçanta dhe të përshtatshme për verifikimin kufitar të mjeteve të rënda dhe ngarkesave në to;

#### 2. Pajisje tekniko-policore dhe pajisje të tjera speciale si në vijim:

- porta stacionere për zbulimin e radiokativitetit;
- sondë / dedektor për matjen e nivelit të CO<sub>2</sub>;
- pajisje video - optike për inspektimin e automjeteve të rënda;
- komplete pajisjesh profesionale për zbërthim mbërthim të automjeteve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre;

#### 3. Hardware dhe software për kompjuterizimin e sistemit të verifikimit kufitar:

- baza të dhënash për verifikimin optimal të personave, automjeteve dhe mallrave në vijën e parë dhe të dytë;
- stacione pune (kompjuter i lidhur në rrjet) të standardit profesional me burim të pa ndërprerë energjie në ambientet e verifikimit të automjeteve dhe mallrave në vijën e dytë;
- baza të dhënash të përshtatshme mbi kompanitë e transportit që operojnë me mjete dhe mallra.